



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva**

---

**Nr.06-111/01-0101710/22**

**Dt.13.12.2022**

Bazuar në Nenet 79 dhe 80 të Ligjit Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publik të Republikës së Kosovës, Rregulloren (Qrk) Nr. 05/2022 për Procedurat Konkurruese dhe Pranimi për Nëpunësit Administrativ dhe Mbështetës, si dhe në bazë të kërkesës së QKMF-së Nr.1678, Komuna e Podujevës shpall:

**KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË LIRË TË PUNËS**

**DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE**

**QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE**

**Pozita: Mirëmbajtës - 1 (një) pozitë**

**Koeficienti: H - 314 / 1**

**Lloji i vendit të punës: Me afat të pacaktuar, me orar të plotë (Periudha provuese 6 (gjashtë) muaj).**

**Përshkrimi i detyrave të punës :**

- Kryen punë të ndryshme zejtare të nevojshme lidhur me meremetime të vogla në të gjitha njësitë-repartet e QKMF, QMF dhe AF në teren;
- Bënë mirëmbajtjen e të gjitha instalimeve të ujit, kanalizimit;
- Mirëmbajtja e ndërtesave në Qendër dhe teren;
- Kryen edhe punë të tjera nga lëmia përkatëse e tij;
- Mirëmban parkingun, kopshtin etj;
- Sipas urdhërësës së eprorit kryen edhe punë të tjera nga lëmia e tij;
- Për punën e vet i përgjigjet shefit të shërbimit dhe Drejtorit.

**Kërkesat e përgjithshme për pranim:**

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

**Kualifikimi i kërkuar:**

-Diplomë e Shkollës së Mesme

**INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR TË GJITHË KANDIDATËT****Dokumentet e Kërkuara:**

-Diploma e kualifikimit përkatës;

-Kopja e Letërnjoftimit;

-Certifikatën që nuk jeni nën hetime;

-Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor që dëshmon se gjendja e kandidatit është pa probleme shëndetësore (Kjo dëshmi sillet pas pranimit në mardhënje pune të kandidatit);

-Dokumentet i dërgoni fotokopje sepse të njëjtat nuk kthehen.

**Afati i aplikimit:**

Data e njoftimit në webfaqen unike të procedurave të konkurimit <https://konkursi.rks-gov.net> është prej dt. 13.12.2022 deri me dt.27.12.2022.

**Afati për paraqitjen e aplikacioneve është 15 ditë, nga data 28.12.2022 deri me datën 11.01.2023.**

Përveç web faqes unike të procedurave të konkurimit, konkursi publikohet edhe në web-faqe zyrtare të Komunës.

Komuna e Podujevës ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional, siç specifikohet në Ligjin për Zyrtarët Publikë.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Vlerësimi i kandidatëve bëhet nëpërmjet vlerësimit të jetëshkrimit dhe një interviste me gojë.

Fletëaplikacionet merren në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë, në ndërtesën e Kuvendit të Komunës.

Kërkesat me dokumente të kompletuara dorëzohen në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë.

Për çdo informatë plotësuese mund të kontaktoni në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në këtë numër të telefonit 038 200 41-005.

**Rezultatet shpallen në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/>**